

BULETINI



KOMUNA E LIPJANIT
KORRIK 2026

KOMUNA E LIPJANIT DHE STACIONI POLICOR ORGANIZOJNË TAKIM INFORMUES

Në kuadër të takimeve të rregullta për policimin në bashkësi, u mbajt takimi i radhës ku u diskutua për gjendjen e sigurisë në Komunën e Lipjanit, me fokus në parandalimin e zjarreve dhe gjuajtjeve me armë gjatë ahengjeve.

Komandanti i Stacionit Policor në Lipjan kapiteni Brahim Shatrolli, theksoi se gjendja e sigurisë në komunë vazhdon të jetë e qetë dhe stabile falë bashkëpunimit ndërmjet Policisë, institucioneve dhe qytetarëve. Ai apeloj për kujdes dhe përgjegjësi më të madhe në parandalimin e zjarrvënies dhe prezantoi statistikën e punës së stacionit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2026.

Nënkryetari i Komunës së Lipjanit z. Diamant Bytyqi, vlerësoi bashkëpunimin e shkëlqyer ndërmjet Komunës dhe Policisë së Kosovës, duke theksuar rëndësinë e koordinimit institucional për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike. Ai gjithashtu u bëri thirrje qytetarëve të tregojnë kujdes të shtuar për të parandaluar zjarret dhe dukuritë e tjera që cenojnë sigurinë e përgjithshme.

Pjesëmarrësit ritheksuan përkushtimin për bashkëpunim të vazhdueshëm në parandalimin e dukurive negative.



KRYETARI I KOMUNËS SË LIPJANIT Z. IMRI AHMETI, I SHOQËRUAR NGA BASHKËPUNËTORËT E TIJ, KA PRITUR NË TAKIM MINISTREN E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR ZNJ. FITORE PACOLLI, SI DHE PËRFAQËSUES TË TJERË NGA KJO MINISTRI.

Temë diskutimi ishte deponia e mbeturinave e propozuar nga Qeveria e Kosovës për t'u ndërtuar në Komunën e Lipjanit, konkretisht në afërsi të zonës industriale në Kërçevë.

Kryetari z. Imri Ahmeti ka thënë se çështja e lokacionit për deponim në zonën e Kërçevës është e pajustificueshme dhe bie në kundërshtim me të gjitha kriteret për deponi sanitare.

Kryetari Ahmeti po ashtu ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunim me Ministrinë përkatëse që të zgjidhet ky problem jetik për rajonin e Prishtinës, por edhe për vendin në përgjithësi.

Ndërsa, drejtori për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit z. Imri Semetishti, ka prezantuar me slajde detajet e lokacionit të propozuar nga Qeveria e Kosovës për ndërtimin e kësaj deponie në Lipjan, si dhe ndikimet negative që mund të sjellë ndërtimi i kësaj deponie në këtë zonë, pasi që në kufi të saj gjendet Zona Ekonomike, në të cilën janë bërë investime të mëdha, po ashtu në kufi me rezervatin e Blinajës, pastaj në afërsi dhe në mes të 5 fshatrave të banuara, si dhe në afërsi të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës etj.

Nga ana tjetër ministrja znj. Fitore Pacolli, ka falënderuar kryetarin Ahmeti për pritjen, si dhe përfaqësuesit komunalë të cilët kanë informuar në hollësi lidhur me pozicionin se ku kishte propozuar Qeveria ndërtimin e kësaj deponie. Në të njëjtën kohë, ministrja Pacolli u dakordua që në vazhdim të bashkërendojnë aktivitetet në zgjidhjen e këtij problemi.

Në fund të takimit kryetari Ahmeti, ka ofruar gatishmërinë e tij institucionale për të shkuar drejt zgjidhjes së këtij problemi.



KOMITETI PËR KOMUNITETE KA ZHVILLUAR PUNIMET E MBLEDHJES SË 6-TË ME RADHË



Në sallën e takimeve të Komunës së Lipjanit, u mbajt mbledhja e 6-të e Komitetit për Komunitete (KK), e udhëhequr nga kryesuesi, z. Alush Bikliqi, ku u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës.

Gjatë takimit zyrtari për Buxhet dhe Financa informoi anëtarët e komitetit lidhur me planifikimin buxhetor të Komunës së Lipjanit për periudhën 2027–2029.

Në përfundim të mbledhjes, anëtarët e Komitetit shqyrtuan disa çështje dhe kërkesa të ndryshme të paraqitura nga komunitetet.

KRYETARI AHMETI MORI PJESË NË PËRURIMIN E KLASËS SË PARASHKOLLORËVE NË RIBAR TË MADH

Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, mori pjesë në ceremoninë e përrurimit të klasës së parashkollorëve në SHFMU “Kadri Beba” në Ribar të Madh, investim i realizuar nga Kontingjenti Turk i KFOR-it.

Me këtë rast Kryetari z. Imri Ahmeti, falënderoi KFOR-in Turk për këtë investim, i cili kontribuon drejtpërdrejt në krijimin e kushteve më të mira për edukimin dhe zhvillimin e fëmijëve në moshë të hershme.

Ndërkaq komandanti i KFOR-it Turk z. Harun Elitas, theksoi se janë të lumtur që përmes këtij projekti po kontribuojnë në mbështetjen e iniciativave që ndikojnë pozitivisht në edukimin dhe mirëqenien e fëmijëve.



KRYETARI AHMETI PRITI NË TAKIM KAMPIONET E KOSOVËS NË HENDBOLL TË KHF "ULPIANA" U14

Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim ekipin e kategorisë U14 të Klubit të Hendbollit për Femra "Ulpiana", të cilat janë shpallur kampione të Kosovës.

Gjatë takimit kryetari Ahmeti, i uroi sportistet dhe stafin e klubit për këtë sukses të jashtëzakonshëm.

"Kur kemi suksese të tilla krenohemi të gjithë, ju na keni bërë krenarë neve dhe të gjithë qytetarët e Lipjanit. Ju siguroj se Komuna do të vazhdojë t'ju mbështesë, sepse suksesi juaj është sukses i gjithë Lipjanit", tha Kryetari, z. Imri Ahmeti.

Përfaqësuesit e klubit e falënderuan kryetarin Ahmeti për mbështetjen e vazhdueshme, duke theksuar se ky titull është rezultat i punës së palodhshme dhe përkushtimit të stafit dhe sportisteve të reja.



KOMITETI PËR KOMUNITETE VIZITOI JANJEVËN NË KUADËR TË MBLEDHJES SË 7-TË ME RADHË

Në Janjevë u mbajt mbledhja e 7-të e Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit, e udhëhequr nga kryesuesi z. Alush Bikliqi, me qëllim të vlerësimit të gjendjes aktuale dhe identifikimit të nevojave që prekin komunitetet në këtë lokalitet.

Gjatë vizitës në terren, anëtarët e komitetit u njohën nga afër me sfidat dhe çështjet me të cilat përballen komunitetet në Janjevë, si dhe morën informacione relevante për trajtimin e tyre në kuadër të kompetencave institucionale.



NËNKRYETARI BYTYQI NDERON ME HOMAZHE DËSHMORIN SADIK SHALA

Nënkryetari i Komunës së Lipjanit z. Diamant Bytyqi, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët, ka bërë homazhe dhe ka vendosur buqeta me lule pranë varrit të dëshmorit Sadik Shala, në Kompleksin Memorial të Brigadës 121 “Kumanova” në Kleçkë, në nderim të jetës dhe veprës së tij, me rastin e 28-vjetorit të rënies.

Nënkryetari Bytyqi theksoi se dëshmorët janë themeli mbi të cilin u ndërtuan liria dhe shteti i Kosovës, kujtimi për Sadik Shalën mbetet i gjallë jo vetëm te familja e tij, por edhe te të gjithë qytetarët që vlerësojnë sakrificën e atyre që dhanë jetën për lirinë e vendit.

Lavdi të gjithë dëshmorëve të lirisë!



KRYETARI AHMETI PRITI NË TAKIM DREJTORIN E QATAR CHARITY

Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim drejtorin e Qatar Charity në Kosovë z. Ahmad Al Ashal, me të cilin ka diskutuar për investimet në sistemin e ujësjellësit. Gjatë takimit Kryetari Ahmeti vlerësoi mbështetjen e Qatar Charity në realizimin e projektit të ujësjellësit në Krojmir, i cili pritet të ndikojë në përmirësimin e furnizimit me ujë për banorët e këtij fshati. Po ashtu u diskutua edhe për fillimin e investimeve në ujësjellësin e Vrellës së Goleshit, projekt i rëndësishëm që parashihet rehabilitimin e rrjetit ekzistues dhe përmirësimin e cilësisë së furnizimit me ujë për qytetarët e kësaj zone. Drejtori i Qatar Charity në Kosovë z. Ahmad Al Ashal, ka falënderuar kryetarin Ahmeti, për mbështetjen dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm, i cili ka mundësuar arritjen e rezultateve konkrete në këto projekte. Ai shprehu gatishmërinë për vazhdimin e partneritetit edhe në projekte të tjera në dobi të qytetarëve të Lipjanit.



FILLUAN AKTIVITETET E FESTIVALIT “MËRGATA FEST & SPORTS” NË LIPJAN

Sheshi “Adem Jashari” mbrëmë u shndërrua në një hapësirë plot gjallëri, buzëqeshje dhe atmosferë festive me hapjen e aktiviteteve të festivalit “Mërgata Fest & Sports”. Aktivitetet e para të festivalit sollën argëtim për më të vegjlit përmes lojërave të ndryshme, maskotave, pikturimit të fytyrës dhe aktiviteteve të tjera rekreative, duke krijuar një atmosferë që mbloodhi së bashku familje, bashkatdhetarë dhe qytetarë të shumtë.

Festivali do të vazhdojë edhe në ditët në vijim me aktivitete sportive, kulturore dhe argëtuese për të gjitha grupmoshat. Ju mirëpresim!



ZHVILLIMI I FAZËS V TË ZONËS EKONOMIKE QYLAGË

Drejtori për Ekonomi dhe Zhvillim i Komunës së Lipjanit z. Valon Pacolli, së bashku me përfaqësues të ekzekutivit, ka zhvilluar takim pune me u.d. Sekretarin e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë z. Artan Demolli, si dhe me përfaqësues të KIESA-s, në kuadër të zbatimit të Memorandumit të Bashkëpunimit për zhvillimin e Fazës së V-të të Zonës Ekonomike Qylagë.

Gjatë takimit u shqyrtuan hapat konkretë për realizimin e kësaj faze me fokus në zhvillimin e infrastrukturës moderne, planifikimin e hapësirave të gjelbra dhe integrimin e zgjidhjeve të bazuara në energjinë e ripërtëritshme. Gjithashtu u theksua nevoja për lëvizjen tutje me hapa më të shpejtë, me qëllim avancimin e proceseve për zhvillimin e infrastrukturës dhe realizimin sa më efikas të kësaj faze.

Zona Ekonomike Qylagë tashmë është funksionale dhe aktive, ndërsa zhvillimi i Fazës së V-të synon zgjerimin e kapaciteteve të saj, krijimin e kushteve më të favorshme për investime dhe mbështetjen e zhvillimit të bizneseve, duke kontribuar në rritjen e aktivitetit ekonomik në Komunën e Lipjanit.



ATMOSFERË SPORTIVE, ENERGJI DHE GARË NË DITËN E DYTË TË “MËRGATA FEST & SPORTS”

Emocione sportive, rivalitet miqësor dhe pjesëmarrje e madhe karakterizuan aktivitetet e mbrëmshme të festivalit “Mërgata Fest & Sports”, ku pjesëmarrës të shumtë garuan në disiplinat e paragllajdit, ping-pongut për seniorë, shahut, soccer flipper, bilardos dhe shigjetarisë.

Përmes këtyre aktiviteteve “Mërgata Fest & Sports”, vazhdon të bashkojë qytetarët dhe bashkatdhetarët në një frymë sportive, argëtimi dhe bashkëpunimi, duke sjellë gjallëri, energji dhe momente të veçanta në zemër të qytetit.

Ju mirëpresim sonte në aktivitetet e radhës.



KPF MBAN MBLEDHJEN E 6-TË ME RADHË



Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), i udhëhequr nga Kryesuesi i Kuvendit z. Daut Azemi, ka mbajtur mbledhjen e 6-të me radhë, ku janë shqyrtuar të gjitha pikat e rendit të ditës të propozuara për këtë mbledhje.

Gjatë këtij takimi, Kryesuesi i Kuvendit z. Daut Azemi, përveç pikave të parapara në rendin e ditës, ka propozuar edhe një pikë shtesë për diskutim.

Pas diskutimeve, anëtarët e KPF-së kanë rekomanduar të gjitha pikat për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet të premten më 31 korrik 2026.

SPORTI, ARGËTIMI DHE FRYMA GARUESE PËR TË GJITHA MOSHAT KARAKTERIZUAN NATËN E TRETË TË AKTIVITETEVE TË FESTIVALIT “MËRGATA FEST & SPORTS”

Garat në bilardo , shah , ping-pong dhe soccer flipper mbledhën pjesëmarrës të shumtë, duke krijuar një atmosferë të veçantë dhe duke sjellë momente të paharrueshme për qytetarët dhe bashkatdhetarët. Disa nga momentet më të veçanta të aktivitetëve.



U MBAJT MBLEDHJA E 8-TË ME RADHË E KUVENDIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Kuvendi i Komunës së Lipjanit i udhëhequr nga Kryesuesi z. Daut Azemi, zhvilloi punimet e mbledhjes së 8-të me radhë, në të cilën u shqyrtuan dhe u miratuan të gjitha pikat e rendit të ditës të propozuara për këtë seancë. Nënkryetari i Komunës së Lipjanit z. Diamant Bytyqi, gjatë kësaj seance ka dhënë sqarime për të gjitha pyetjet dhe çështjet e ngritura nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.



FINALJA E AKTIVITETEVE SPORTIVE TË “MËRGATA FEST & SPORTS” SJELLI EMOCIONE DHE ATMOSFERË FESTIVE

Në Sheshin “Adem Jashari”, u zhvillua finalja e aktiviteteve sportive në kuadër të festivalit “Mërgata Fest & Sports”, ku dhjetëra garues u përballën në disiplina të ndryshme sportive dhe rekreative.

Publiku pati mundësi të ndjekë garat në ping-pong për seniorë, juniorë dhe persona me nevojë të veçantë, shah, arm wrestling në tri kategori, biliardo, soccer flipper dhe shigjetari.

Fituesit e vendeve të para, të dyta dhe të treta u shpërblyen për rezultatet e arritura, ndërsa atmosfera në shesh u karakterizua nga energjia, entuziazmi dhe përkrahja e qytetarëve.





Komuna e Lipjanit – Zyra për informim



<https://lipjan.rks-gov.net/>



infokomuna.lipjan@rks-gov.net



0 800 14 000 / 038 200 41 508